



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOŠOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.432/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret: Hajriz Hoti kryesues, Kujtim Pasuli dhe Ramush Bardiçi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik, Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), me seli në Prizren, të paraqitur kundër Subjektit Politik, Opre Roma Kosova, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 09.02.2025, merr këtë,

V E N D I M

I. Pranohet e bazuar ankesa e Subjektit Politik, Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), me seli në Prizren, Anr.432/2025, e datës; 07.02.2025.

II. Subjektit Politik, Opre Roma Kosova, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 1.000.00 (njëmijë) euro.

III. Detyrohet Subjekti Politik, Opre Roma Kosova, me seli në Prishtinë, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 07.02.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Subjekti Politik, Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), me seli në Prizren, me të cilën pretendon se më datë 06.02.2025 rreth orës 11:15, në rrugën "Suzi Çelebia" në Prizren, përballë kuvendit komunal në Prizren, partia politike, Opre Roma Kosova ka vendosur afishe/postera në drunjë gjë që ka shkelur dispozitat ligjore të parapara me ligj. Gjithashtu në ankesë theksohet se vendi/hapësira ku është vendosur posteri i përket zonës historike të qytetit të Prizrenit, dhe se ankesa bazohet në Rregulloren Zgjedhore Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar respektivisht në nenin 7 të kësaj rregullore.

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik, Opre Roma Kosova, theksohet se shprehim keqardhje për këtë shkelje, me rastin e posterit të vendosur në dru, dhe se me gjithë përpjekjet për të njoftuar aktivistet tanë për rregullat, jo të gjithë i kanë pasur mjaft të qarta, ndaj dhe kanë bërë gabim. Megjithatë siç e parasheh edhe neni 7 i Rregullores Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, në rast të evidentimit të ndonjë shkelje, KKZ njofton menjëherë subjektin politik në fjalë që të marrë masa korrigjuese, si dhe

ndërkohë ne kemi marrë masa korigjuese sa me pare, për të larguar posterët nga drunjat dhe për të mos shkelur asnjë rregullore të paraparë nga dispozitat ligjore.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, ankesën dhe përgjigjen në ankesë, vëren se ankesa është bazuar

Paneli, nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë ka konstatuar se vendosja e posterit të kandidatit për deputet Sebastiajn Serifovic, nga radhët e subjektit politik, Opre Roma Kosova, i vendosur në drunj, është në kundërshtim me Rregulloren Zgjedhore Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar konkretisht neni 7 paragrafi 2 nën paragrafi 2.11 i cili parasheh: 2 " *Materiali i subjekteve politike nuk duhet të vendoset si në vijim: 2.11 " në drunj të qytetit"*.

Prandaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "*vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të qëndrueshme dhe si të tilla i pranoi, sepse kjo shkelje ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e pranoi si të bazuar. Paneli po ashtu mori edhe thëniet në përgjigjen në ankesë ku theksohet se shprehim keqardhje për këtë shkelje, me rastin e posterit të vendosur në dru, dhe se me gjithë përpjekjet për të njoftuar aktivistët tanë për rregullat, jo të gjithë i kanë pasur mjaft të qarta, ndaj dhe kanë bërë gabim, si dhe ndërkohë ne kemi marrë masa korigjuese sa me pare, për të larguar posterët nga drunjat dhe për të mos shkelur asnjë rregullore të paraparë nga dispozitat ligjore, dhe për këtë arsye mori si rrethane lehtësuese masat e ndërmarra për largimin e posterit si dhe shprehjen e keqardhjes për shkeljen e bërë.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, shkeljet e Ligeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje si dhe faktin që shkelja nga ky subjekt është bërë për herë të parë, njëherit subjekti politikë në fjalë nuk është përfitues i fondit për financimin e subjekteve politike përmes buxhetit të Republikës së Kosovës, si dhe evitimin e shkeljes se bere dhe ndërmarrjen e masave përmirësuese.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar në nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
A.nr.432/2025, datë 09.02.2025

Kryesues i Panelit  
Hajriz Hoti

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform neni 118 paragrafi 4 të LZP-së.